



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:234566

Datë: 31.07.2024

Numri i dokumentit: 06005662

KPPP.nr.1759/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Kompania Regjionale e Mbeturina Ekoregjioni” SH.A., me NUI: 811324152, me seli në rr. “Tahir Sinani”, Nr. 59, Njësia Operative në Rahovec, kundër debitorit F.B. B.I. - D.P.Z. “Diellza”, me NRB: 70273671, me seli në Rr. “Xhelal Hajda”, në Rahovec, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.581/21 të datës 23.09.2021 të Përmbartuesit Privat Gjokë Radi me seli në Gjakovë, jashtë seancës, me datë 31.07.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit F.B. B.I., - D.P.Z. “Diellza” ANULOHET Urdhri Përmbartimor P.nr.581/21 i datës 23.09.2021, i Përmbartuesit Privat Gjokë Radi dhe PËRFUNDOHET në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Kompania Regjionale e Mbeturina Ekoregjioni” SH.A., ka caktuar urdhrin përmbartimor P.nr.581/21 të datës 23.09.2021, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm - Kartelës së konsumatorit L 0563513 të lëshuar nga kreditori, me të cilin është detyruar debitori që në emër të përmbartjes së obligimeve të papaguara nga kartela e konsumatorit të lartcekur për periudhën kohore Janar 2009 – Gusht 2021, brenda afatit prej 7 ditësh nga data e dorëzimit të urdhrin t’ia paguajë kreditorit shumën prej 356.64 €, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore, ashtu që të gjitha detyrimet të realizohen përmes zbatimit të përmbartimit sipas llogarive bankare të debitorit dhe nëse debitori nuk posedon mjete monetare në llogarinë e tij bankare, përmbartimi

të zbatohet përmes sekuestrimit të sendeve të luajshme dhe të paluajshme të debitorit dhe me shitjen e tyre të bëhet inkasimi i borxhit në llogari të kreditorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbartimor, duke theksuar se propozimi për përmbartim ka të meta dhe po ashtu borxhi i kërkuar është parashkruar sipas Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, duke theksuar që kreditori në mënyrë paushalle dhe retroaktive e ka ngarkuar debitorin për një borxh të vjetër dhe pa asnjë bazë ligjore. Gjykatës i ka propozuar që të anulohet urdhri i përmbartuesit privat.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, i ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, duke theksuar se nuk ekziston asnjë nga arsyet që debitorit mund të i lejohet eventualisht aprovimi i prapësimin, pasi që të gjitha shkresat dhe provat gjenden në shkresa të lëndës së bashku me dokumentet e besueshme të cilat sipas LPP-së, konsiderohen titull ekzekutiv dhe dokumente të besueshme. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet prapësimi i debitorit si i palejueshëm dhe i pa bazë.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit si dhe shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (tutje LPP) dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbartimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbartimor duhet të anulohet dhe procedura përmbartimore të përfundohet në tërësi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm - kartela e konsumatorit L 0563513, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbartim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se “Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, ndërsa në par.2 të po këtij neni, si dokument i besueshëm sipas ligjit konsiderohen “*ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave*”, ndërsa me nenin 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se “*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar*”, kurse me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “*Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm,*

mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”

Në rastin konkret pavarësisht faktit se propozimi për përmbardim është lejuar sipas Ekstraktit nga librat e kontabilitetit - Kartela Financiare e Konsumatorit në kuadër të “Kompania Regjionale e Mbeturinave Ekoregjioni” SH.A., gjykata gjeti se dokumenti mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbardim, e mbi bazën e të cilit përmbarduesi privat ka lejuar përmbardimin, nuk i plotëson kushtet që të konsiderohet dokument i besueshëm për shkak që nuk i përmban tiparet e një ekstrakti nga librat afarist, meqenëse në këtë dokument nuk evidentohet saktësisht periudha kohore për të cilën kërkohet përmbardja e detyrimit.

Nga ekstrakti afarist i bashkëngjitur sipas shifrës L 0563513, figuron periudha kohore prej datës 01.01.2019 ku edhe borxhi fillestar rezulton të jetë 291.21 €, deri tek data 31.08.2023 ku vlera e borxhit është 354.64 €, ndërsa në përmbardjen e këtij ekstrakti, nuk është përfshirë fare shërbimet dhe shuma e borxhit të tyre para periudhës 01.01.2019, me ç' rast nuk dihet se për cilat shërbime dhe për cilën periudhë kohore është grumbulluar borxhi në fjalë.

Meqenëse dokumenti në bazë të së cilit është lejuar urdhri përmbardimor, përkatësisht kartela e konsumatorit L 0563513, nuk është dokument i besueshëm dhe nuk ka tipare të përmbardueshmërisë, gjykata nuk i shqyrtoi fare pretendimet tjera të debitorit të paraqitura në prapësim dhe kreditorit të paraqitura në përgjigjen në prapësim dhe duke u bazuar në nenin 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, nenin 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbardimore, si dhe nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1759/23 datë 31.07.2024

Gjyqtari

Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.